

TË JESH IMAM NË EPOKËN DIGJITALE

Me nocionin “imam” nënkuptojmë nëpunësit fetarë që në forma të ndryshme shërbejnë në predikimin dhe jetësimin e islamit si dhe në bartjen e tij në gjenerata të ardhshme, duke përfshirë natyrisht edhe gjininë femërore që shërben në këtë sferë. Sa i përket të mësuarit përgjatë jetës, imamët janë po ashtu shërbyesit që luajnë rolin e mësuesit gjatë jetës duke iu ligjëruar nëpër xhami besimtarëve të moshave të ndryshme nga të vegjlit e deri te të moshuarit. Dihet tashmë, që kjo nuk ndodh deri në një afat të caktuar, por gjatë tërë jetës.

Bota sot është shndërruar në një fshat global, kurse popujt në të, në një shoqëri të vetme multikulturore. E gjitha kjo, falë zhvillimeve teknologjike në sferën e transportit dhe të komunikimit. Zhvillimet në sferën e teknologjisë në shekullin XXI kur të krahasohen me ato të shekullit XX do të jenë një mijë fish më të mëdha.¹

Për shkak të zhvillimeve në mënyrë konstante dhe me shpejtësi marramendëse vërehet rëndësia e mësimit gjatë gjithë jetës. Nga ndryshimet dhe investimet, sado që të jenë të vogla, njeriu do të detyrohet çdo herë të qëndrojë aktual. Prandaj mbijetesa në epokën digjitale si për individin ashtu edhe për shoqërinë do të varet nga fakti se sa ata do ta zhvillojnë veten në mënyrë paralele me zhvillimet e kohës. Ndryshimi mes personave që nuk do të mësojnë vazhdimisht dhe nuk do tregojnë interesim për mësim gjatë gjithë jetës do reflektojë si dallim në kualitetin e jetesës së tyre.²

Numri i konsumatorëve të rrjeteve sociale ka arritur në gjysmën e popullsisë së botës. Në njëzet vitet e fundit në mbarë botën numri i të rinjve me varësi nga bota virtuale ka arritur në miliona.³ Analizat akademike për efektet e saj ende nuk janë në nivelin e duhur. Në Turqi u themelua shoqata e parë e medias sociale, ndoshta në nivel botëror, “USMED”, e

* Ligjërues i lëndës Kurani dhe texhvidi në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup, referent për shkencë dhe kulturë, pranë Muftinisë BFI-Gostivar.

1 Dağıtmaç, Dr. Murat-Ekmen, Şehadetö Dijital Psikolojik Devrim, İstanbul, 2019, f. 14.

2 Canan, Sinan-Acungil, Mustafa, Dijital Gelecekte İnsan Kalabilmek, İstanbul, 2019, f. 164,165.

3 Çalalık, Erdogan, Kuresel Sistemde İnsan Kalkmak, İstanbul, 2015, f. 94.

cila kujdeset për zhvillimin dhe moralin rinisë, duke organizuar programe për vetëdijesimin dhe efekteve negative të rrjeteve sociale si dhe përgatiti orientime në lidhje me përdorimin e teknologjisë për qëllime produktive.⁴ Krahas punës për vetëdijesim të përdorimit të teknologjisë, duhet me kujdes të veçantë të ndalemi edhe te metodat e një lloj detoksi digjital apo agjërimit digjital që do të na mbrojnë nga efektet negative dhe varësia ndaj teknologjisë.⁵ Por ajo që duhet ditur për epokën digjitale është se nuk mund të themi le ta ndërpresim internetin, t'i zhdukim telefonat dhe tabletat apo t'i shkëpusim kompjuterët nga energjia elektrike...⁶ Teknologjia është si plehu, kur i hidhet me masën e duhur bimës e rrit atë, ndërsa kur provohet e than atë.⁷

Islami në epokën digjitale

Një grup arkeologësh europianë në shoqërimin e disa udhërrëfyesve indianë u drejtuan drejt tempujve të inkave. Për një kohë të shkurtër ata e përgjysmuan rrugën drejt tempujve. Pasi kaluan edhe pak rrugë, vendasit pas një bisede me njëri-tjetrin, papritmas u ulën dhe filluan të presin të ulur. Arkeologët europianë, duke mos ditur shkakun e pritjes, ndenjën të ulur së bashku me ta. Pas disa orësh vendasit sërish biseduan në mes tyre dhe vazhduan rrugën. Njëri nga arkeologët e pyeti plakun e udhërrëfyesve: - Më falni, nuk e kuptova shkakun pse pritëm këtu orë të tëra? Përgjigjja e plakut ishte: - Për një kohë të shkurtër ecëm shumë. Shpirtrat na mbetën pas nesh, u ulëm që t'i presim të na arrijnë.⁸ Ne garojmë, vrapojmë me një shpejtësi të madhe, në një jetë të përshpejtuar me teknologji, në një jetë dinamike, duke veçuar vetëm kërkesat trupore dhe duke mos e kuptuar rëndësinë e shpirtërores, posaçërisht në këtë epokë ku njeriu më së tepërmi ka nevojë që ta ruajë këtë anë kryesore që e bën atë njeri.

Feja si fenomen do jetë ndër më të rëndësishmet për njeriun edhe në të ardhmen. Kjo do të jetë kështu, ngaqë njeriu ka gen për besim dhe nevoja e tij për shpirtëroren në çdo kohë do të jetë aktuale. Rrugëtimi i njeriut drejt gjetjes së kuptimit nuk do të mbarojë edhe në të ardhmen. Ky është elementi dallues i njeriut në krahasim me gjithë gjallesat e tjera. Thuhet se shumë profesione në të ardhmen do të merren nga duart e njeriut për t'ua

4 Ercan, Said, Dijitalizm, İstanbul, 2019, f. 20.

5 Karadağ, Gökmen H., Dijital Hastalıklar, İstanbul, 2019, f. 171.

6 Samur, Yavuz, Yeni Bir Bildiriminiz Var, İstanbul, 2020, f. 120.

7 Goodëin, Kristy, Dijital Dünyada Çocuk Büyütmek, İstanbul, 2018, f. 28.

8 Acet, Mehmet, Yeni Şafak, 29 Haz, 2016, Çarşamba.

besuar robotëve me inteligjencë artificiale. Por ajo në të cilën robotët nuk do të mund ta tejkalojnë njeriun do jetë gjetja e kuptimit.⁹ Krahas feve botërore edhe fe të llojit “New age” çdo herë me versione të ndryshme do të serviren me qëllim të ofrimit të kuptimit për njeriun në epokën digjitale, por nuk do ta kenë potencialin e përgjigjes së kërkesave të njeriut.¹⁰ Ekspertët e digjitalizimit, kur është në pikëpyetje islami, kanë mendimin që është opsioni ideal për njeriun e epokës digjitale. Shembullin e përkryer që ofron islami për epokën digjitale e vërejmë edhe te mendimtarë perëndimorë. Ja çfarë thotë George Bernard Shaw: “Çdo herë kam pasur respekt ndaj fesë tepër dinamike të Muhamedit. Siç duket islami është e vetmja fe që ka thirrje për çdo shekull. Shumë herë e kam theksuar mendimin tim se islami është i pranueshëm dhe i përshtatshëm si për Europën e sotme, po ashtu edhe për të ardhmen. Në shekullin e ardhshëm këtë mund ta bartim edhe më tej duke kuptuar dobitë e kësaj feje, e cila do të ofrojë zgjidhje për problematikat e botës së sotme”.¹¹ Ndaj, kur bëhet fjalë për ardhmërinë e islamit, fe e cila do të jetë opsion më i fuqishëm për njeriun e epokës digjitale, kuptojmë që rolin kyç të jetësimit dhe të përfaqësimit denjësisht të islamit padyshim që e kanë myslimanët.

Kur është në diskutim sektori i lojërave kompjuterike, për fat të keq shoqëritë myslimane kanë qëndruar pasive në këtë çështje. Ndoshta edhe nga bindja negative që kemi formuar për lojërat. Nga ana tjetër, fëmijët dhe rinia e sotme çdo ditë e më shumë konsumojnë lojërat kompjuterike, Prandaj urgjentisht fakultetet teologjike duhet që studentët e programeve Master dhe PHD t'i orientojnë për hulumtime akademike për këtë sferë. Duhet të organizohen simpoziume që do tërheqin vëmendjen e nëpunësve fetarë dhe hulumtuesve drejt këtij lëmi. Fakultetet teologjike në planpogramet e tyre duhet të përfshijnë lëndë për aftësimin e studentëve për median, televizionin, kinemanë dhe mediat sociale.¹² Bota digjitale në këtë kontekst paraqet mundësi të mira, sepse në shumë gjuhë botërore mundemi të shprehemi dhe të përcjellim mesazhet universale të islamit.

Në një rrjet ku mesatarisht kalojmë 3 deri në 4 orë në ditë nuk diskutohet nevoja për ilmihal digjital që do përmbushë kërkesat që paraqiten në këtë sferë. Natyra nuk pranon zbrazëti. Po qe se nuk do ta ofrojmë ne, padyshim që do ta ofrojnë qarqe që do të kenë qëllimet e tyre. Me ilmihal

9 Canan, Sinan-Acungil, Mustafa, Dijital Gelecekte İnsan Kalabilmek, İstanbul, 2019, f. 172.

10 Po aty, f. 214.

11 Izzetbegovic, Aliza, Islam Deklarasyonu, İstanbul, 2007, f 101.

12 Ince, Yrd. Doç. Abdullah, Dençliğin Gelişimi ve Problemleri Karşısında Din Görevlileri, İstanbul, 2016, f. 227-238.

dijital nënkuptojmë që të realizojmë paraqitjen e problematikave të reja që do sjellin zhvillimet teknologjike dhe që myslimanët të interesohen për qëndrimin e islamit. Kështu, për shembull nëse pas 5 deri 10 viteve, një robot me inteligjencë artificiale shpreh dëshirë dhe pajiset me programet e duhura që të shërbejë si imam, cila do të jetë përgjigjja e bashkësive fetare? Po qe se nuk do jetë menduar për zgjidhjen e këtyre problematikave atëherë përgjigjet do të shfaqen nga grupe jo kompetente dhe marginale.¹³ Botimi i një libri me titullin “Ilmihal i Social Medias për të Rinj”¹⁴ nga autori Abdülaziz Kıranşal në vitin 2019, është një hap shembullor, është hapi i duhur dhe i qëlluar. Në këtë libër krahas çështjeve të fikhut (jurispudencës islame) trajtohen edhe çështje për moralin e të riut gjatë përdorimit të botës virtuale. Ekzistojnë shumë pyetje që presin përgjigje në të ardhmen, si tregtia online në kohë xhumaje dhe dispozita e saj; dispozita e abdesit në rast leximit të Kuranit nga ekranet; a mund të prijë në namaz një robot me inteligjencë artificiale; martesë me robot me inteligjencë artificiale, si dhe shumë pyetje të tjera që kërkojnë inkuadrim të bashkësive fetare me ekipe shkencore për të ofruar përgjigjet e duhura.¹⁵ Sipas autorit, interneti dhe media sociale si kryeaktore për ndryshime ekonomike, shoqërore dhe politike patjetër duhet të ndiqet së afërmi edhe për nga aspektet haram, hallall, mëkat dhe sevap.¹⁶

Xhamitë si vende rehabilitimi

Një e treta e kompanive amerikane sot organizojnë programe për minimalizimin e stresit. Këtë e bëjnë duke u siguruar punonjësve dhoma meditimi, joga apo qetësimi, në të cilat ata qëndrojnë në pak minuta brenda ditës që të qetësohen nga ana mendore, gjë që reflektohet pozitivisht në rritjen e produktivitetit në punë të kompanitë e lartpërmendura. Për shembull, firma e njohur për prodhimin e çipave për kompjuterë, Intel, çdo të martë ka një praktikë katër orëshe me emrin “kohë e qetë” ku nga 300 inxhinierë dhe udhëheqës kërkohe mbyllja e celularëve dhe e postave elektronike si dhe vendosja e shkrimit të dera e zyrës që mos t’i pengojnë. Rezultatet nga kjo praktikë i habitën udhëheqësit e këtyre programeve, sepse 80% e udhëheqësve të lartë të kompanisë “General Milsit” kishin zhvillime të mëdha në edukimin e vullnetit dhe vendosmërisë. Për

13 Dağıtmaç, Dr. Murat-Ekmen, Şehadet, Dijital Psikolojik Devrim, İstanbul, 2019, f. 50, 51.

14 Kıranşal, Abdülaziz, Gençler için Sosyal Medya İlmihali, Ankara, 2019.

15 Kıranşal, Abdülaziz, Gençler için Sosyal Medya İlmihali, Ankara, 2019, f. 120.

16 Po aty, f. 15.

kompanitë amerikane kjo rezultoi me kursim deri në 300 miliardë dollarë në vit.¹⁷ Kjo tregon nevojën e njeriut të sotëm për vende ku duhet të gjejë freski, qetësim, çlodhje nga jeta dinamike. Kompanitë e mëdha botërore çdo ditë e më shumë investojnë për këtë fenomen, që sjell efekte pozitive si për punonjësit ashtu edhe për vetë kompanitë e tyre.

Duke u nisur nga ky fakt, një ndër nevojat e sotme është që në jetën moderne të sqarohet rëndësia e xhamisë në gjetjen e qetësisë shpirtërore, në relaksim krahas jetës dinamike dhe lodhëse dhe rehabilitimin shpirtëror. Psikiatri Prof. Dr. Kemal Sayar në sugjerimet e tij për një çlirim nga prangat digjitale thotë: “Përmendni emrin e Zotit, hyni në faltore, nuhatni në të”!

Xhamitë duhet të ridizajnohen duke marrë parasysh edhe gjeneratat e reja. Në to duhet të krijohen hapësira për lojëra për fëmijë, klasa, hapësira për sport, të vendosen kompjuterë, projektorë, të ketë klasa për lojëra kompjuterike me mundësi mbikëqyrjeje të imamet, në mënyrë që të përfitohet një kulturë e përdorimit të teknologjisë digjitale.¹⁸

Pasurimi intelektual i imamet

Fjala “imam” rrjedh nga rrënja “emm”, në formën e foljes “emme”-shkoi, udhëhoqi, ndërsa imam do të thotë ai që prin, lider, prijës në namaz.

Për pasurimin intelektual të imamet është kusht parimor leximi i rregullt. Gjatë një seminari, njëri nga audienca e pyeti ligjëruesin se si mund të fliste kaq bukur. Ai iu përgjigj duke thënë se unë flas nga brendia. Dëgjuesi pyeti sërish: -Edhe unë flas nga brendësia ime, por pse nuk më del si e folura juaj? Atëherë ligjëruesi i tha: -Atëherë mbushe brendësinë!¹⁹ Këtu vërejmë rëndësinë e leximit, zgjerimin e diapazonit dhe pasurinë intelektuale. Thirrja e autorit Prof. Dr. Faruk Basher që u bëri institucioneve fetare është shumë me rëndësi. Ai thotë:

“Imamet për t’iu dorëzuar qyrsia, duhet të ketë lexuar minimumi pesëdhjetë vepra burimore të kulturës sonë, dhe plus në çdo muaj minimumi të lexojë tre libra që të jetë aktual në çdo kohë. Përndryshe duhet shkarkuar, nëse nuk respekton një vendim të tillë.”²⁰

17 Iyer, Pico, Sükunet Sanatı, İstanbul, 2016, f. 44-45.

18 Ince, Yrd. Doç. Abdullah, Dençliğin Gelişimi ve Problemleri Karşısında Din Görevlileri, İstanbul, 2016, f. 58.

19 Uyan, Salih, Dijital Dünyada E-Beveyn Olmak, İstanbul, 2019, f. 73.

20 Başer, Prof. Dr. Faruk, Yeni Şafak, 24 Şubat, 2019.

Institucionet fetare duhet të kenë parasysh programe për metoda efektive të leximit, shndërrimit të leximit në shprehje, shpejtleximit, dhe shumë projekte të lidhura me leximin, gjë e cila padyshim do ta çojë si shoqëri në një shkallë edhe më të lartë.

Krahas pajisjes me njohuri duke lexuar libra, ka edhe çështje të tjera që imami patjetër duhet t'i ketë në konsideratë. Një nga ato është mënyra e përcjelljes së mesazheve në shoqëri. Sipas shumë hulumtimeve, në komunikim efekti i fjalëve është 7%, tonaliteti i zërit, të folurit e drejtë dhe të bukur 38%, ndërsa efekti i gjuhës së trupit është 55%.²¹ Tri elemente të rëndësishme që e rrisin ndikueshmërinë të njerëzimit janë: pamja e jashtme, duke përfshirë edhe veshjen e bukur, biografia e pasur me dije dhe moral dhe gjuha e trupit, duke përfshirë gjestet dhe mimikën.²²

Është fakt që media sociale e uli nivelin e përqendrimit të njerëzimit. Sipas një ankete që bëri Microsofti, niveli i të përqendruarit në botën digjitale e ul përqendrimin eë njeriut në nivelin e peshkut japonez. Kohëzgjatja e fokusimit të një njeriu deri në vitin 2000 ishte mesatarisht 12 sekonda, me hyrjen në botën digjitale ra në 8 sekonda.²³ Kjo tregon për nevojën e marrjes parasysh të drejtimit të ligjëratave nëpër xhami dhe jashtë. Gjatësia e ligjërimeve duhet të jetë konform me nivelin e përqendrimit të sotëm.

Myftinjët mund të organizojnë, kurse për iduhet kërkuar ndihmë nga fakultetet e komunikimit që profesorë kompetentë të ligjërojnë.²⁴ Profesionalizmi në komunikim padyshim që do e rrisë efikasitetin në predikim, gjë që edhe Kurani na porositi duke thënë:

“...dhe njerëzve thojuni fjalë të mira...”

(Sureja Bekare 83).

Imami, në këtë epokë, patjetër duhet të ketë parasysh se xhematliu nuk formohet më vetëm në xhami, por edhe nëpërmjet shtypit, mjeteve audio dhe video, pastaj mjeteve elektronike. Në formimin e tij rol të madh luan media sociale e sodit, ndaj imami duhet të përdorë forma për t'i tërhequr ata në aktivitete sportive, në aktivitete kulturore etj., hapësira të cilat ai duhet t'i shfrytëzojë në maksimum për predikimin e islamit.²⁵

21 Diyanet Ilmi Dergi, f. 82.

22 Özbay, İlyas, İmamlık İrşad ve Cemaatle İletişim, İstanbul, 2020, f. 72.

23 Rigbey, Dr. Elizabeth, Çocuğunuz Dijital Dünyanın Esiri Olmasın, İstanbul, 2019, f. 38.

24 Ince, Yrd. Doç. Abdullah, Dençliğın Gelişimi ve Problemleri Karşısında Din Görevlileri, İstanbul, 2016, f. 270.

25 İbrahimi, Nexhat, İmami dhe Xhemati, Shkup, 2005, f. 16.

Imami duhet të luajë edhe rolin e këshilltarit psikologjik.²⁶ Organizata Botërore e Shëndetësisë pohon se stresi do jetë pandemia e shekullit XXI.²⁷ Madje në të ardhmen e afërt do të jetë ndër problemet e para shëndetësore.²⁸ Ndaj, ndër rolet më me rëndësi të imamit në shekullin e fundit, do të jetë ofrimi i ndihmës shpirtërore për njeriun e sotëm aq të stresuar. Shqetësimet shpirtërore ende janë tabu në shoqërinë tonë kur bëhet fjalë për pranimin e tyre si problem psikik. Problemet dhe çrregullimet psikike kanë qenë dhe janë prezentë gjatë gjithë historisë në shoqëritë njerëzore dhe këshilltarët psikikë të njerëzve kanë qenë pikërisht pejgamberët e Zotit. Shumë lutje të Muhamedit a.s në lidhje me frikën, stresin, ankthin, dhe obsesionet tregojnë kërkesat e shokëve të tij drejtuar te Pejgamberi a.s. Imami duhet të jetë në shumë kënde të jetës pranë shoqërisë. Për këtë, edhe Pejgamberi a.s herë pas here iu drejtohej shokëve duke i pyetur:

“Shokët e mi! Sot a i ofruat ushqim një të varfri? A morët pjesë në ndonjë varrim apo vizitë të një sëmuri?”

(Muslim, Fedailus-Sahabe, 12).²⁹

Mungesa e gjetjes së kuptimit të jetës te njerëzitt shkakton probleme psikike, dhe në vitet që vijojnë kjo shndërrohet në depresion, ankth dhe në çrregullim ankthi.³⁰ Imami, padyshim që duke lexuar për këto tema aktuale, mund t'i ofrojë ndihmë rinisë sonë kundër varësisë nga rrejetet sociale, të ofrojë ndihmë për edukimin e vullnetit, për përfitimin e shprehive pozitive dhe largimin nga shprehitë e këqija.

Disa aftësi që një imam duhet t'i ketë parasysh patjetër në këtë epokë plot sfida, janë:

- Të jetë njohës i mirë i strukturës kulturore të shoqërisë ku jeton.
- Të jetë njohës dhe ndjekës i mirë i botës digjitale.
- Të jetë përvetësues i mirë i metodës së komunikimit të Muhamedit a.s.
- Të jetë ndjekës dhe analizues jo vetëm i zhvillimeve të vendit ku jeton, por edhe i zhvillimeve kulturore dhe shkencore edhe në nivel global.
- Të jetë ndjekës jo vetëm i literaturës fetare, por të ketë njohuri

26 Özbay, İlyas, İmamlık İrşad ve Cemaatle İletişim, İstanbul, 2020, f. 104.

27 Iyer, Pico, Sükunet Sanatı, İstanbul, 2016, s. 45.

28 Sayar, Kemal, Ruh Hali, İstanbul, 2015, s. 141.

29 Diyanet İlimi Dergi, Temmuy, Ağustos, Eylül, 2005, f. 48.

30 Sayar, Kemal, Ruh Hali, İstanbul, 2015, s. 29.

edhe në fusha të tjera si psikologji, pedagogji, sociologji, letërsi, arte etj.

- Ta perceptojë detyrën e vet më tepër se një shërbim civil apo punë shtetërore.
- Të kujdeset për pamjen e jashtme dhe veshjen.
- Të kujdeset për biografinë e tij dhe për mënyrën se si e paraqet atë.
- Të investojë për komunikimin, gjuhën e trupit dhe retorikën.
- Të jetë këshilltar psikologjik i personave të traumatizuar nga vdekja e një anëtarë të familjes dhe i të gjunjëzuarve nga problemet dhe krizat në përgjithësi.
- Të jetë këshilltar për problemet bashkëshortore.
- Të ketë vullnet të çeliktë, durim të paluhatshëm, vetëbesim.
- Të jetë lexues i librit në mënyrë permanente.
- Të ketë dashuri ndaj misionit që kryen.
- Të jetë optimist për ardhmërinë dhe të mbjellë shpresa te shoqëria.³¹

Fjalë përmbyllëse

Teknologjia padyshim që ka anët e saj pozitive si në lëmin e shëndetësisë, mjeteve të transportit dhe shumë përfitime të tjera që kanë sjellë revolucione të mëdha për jetën e njeriut. Rreziku lind nga mënyrat e përdorimit të teknologjisë. Teknologjia na bën asocialë apo përzgjedhjet tona na shndërrojnë në shoqëri asociale? Nëse në një ambient, një grup njerëzish të gjithë kanë në dorë një gazetë apo libër dhe nuk komunikojnë me njëri-tjetrin a quhen asocialë? Kurrsesi jo! Celulari, tableta, gazeta dhe libri janë mjete, kurse zgjedhjet tona të gabuara apo të pakontrolluara na bëjnë asocialë.³² Në realitet, një diskutim rreth teknologjisë nëse është e mirë apo e keqe është i pakuptimtë, është si të diskutosh nëse udhëtimi me aeroplani është diçka e mirë apo e keqe. E kuptimtë është biseda rreth kësaj teknologjie kur fokusohet në atë që si na ndikon, dhe në çfarë na shndërron në jetën tonë. Pavarësisht dëshirës sonë, e vërteta është se ne gjendemi në mes të kësaj teknologjie. Ne duhet të gjejmë mënyrën se si mund ta shndërrojmë atë në produktivitet. Në vend që ta injorojmë këtë revolucion digjital, duhet të mendohemi si ta adaptojmë në jetën e përditshme. Padyshim që nuk kemi receta magjike për këtë, por ajo që

31 Özbay, İlyas, İmamlik İrşad ve Cemaatle İletişim, İstanbul, 2020, f.181-183.

32 Samur, Yavuz, Yeni Bir Bildiriminiz Var, İstanbul, 2020, f. 238,239.

është në duart tona është që të kemi pak disiplinë, të kuptojmë identitetin digjital dhe të vetëdijesohemi për këtë epokë.³³ Asnjë sfidë nuk është e patejkalueshme. Njeriu është i krijuar me natyrë që mund të përshtatet me çdo lloj kushti. Për këtë, mjafton të aktivizojmë vetinë e të menduarit ndryshe, të jemi produktivë dhe mbi të gjitha të përdorim energjitë tona maksimale për t'i ruajtur vlerat që na bëjnë njeri.³⁴

Bibliografia

1. Kur'ani Famëlartë.
2. Acet, Mehmet, Yeni Şafak Gazetesi, 29 Haz 2016, Çarşamba.
3. Başer, Prof. Dr. Faruk, Yeni Şafak Gazetesi, 24 Şubat 2019.
4. Canan, Sinan-Acungil, Mustafa, Dijital Gelecekte İnsan Kalabilmek, Tuti Kitap, İstanbul, 2019.
5. **Çalpak, Erdoğan, Küresel Sistemde İnsan Kalmak, Hayy Kitap, İstanbul, 2015.**
6. Dağıtmaç, Dr. Murat-Ekmen, Şehadet, Dijital Psikolojik Devrim, Motto Yayınları, İstanbul, 2019.
7. Diyanet İlmî Dergi, Temmuz, Ağustos, Eylül, Diyanet İşleri Başkanlığı, 2005.
8. Ercan, Said, Dijitalizm, Motto Yayınları, İstanbul, 2019.
9. Goodëin, Kristy, Dijital Dünyada Çocuk Büyütmek, Aganta Kitap, İstanbul, 2018.
10. **İbrahimi, Nexhat, Imami dhe Xhemati, Logos-A, Shkup, 2005.**
11. **İnce, Yrd. Doç. Abdullah, Dençliğin Gelişimi ve Problemleri Karşısında Din Görevlileri, Ensar Yayınları, İstanbul, 2016.**
12. Iyer, Pico, Sükunet Sanatı, Optimist Yayınları, İstanbul, 2016.
13. **İzzetbegoviç, Aliya, İslam Deklarasyonu, Fide Yayınları, İstanbul, 2007.**
14. Karadağ, Gökmen H., Dijital Hastalıklar, Der Yayınları, İstanbul, 2019.
15. Kıranaşal, Abdülaziz, Gençler için Sosyal Medya İlmihali, MGV Yayınları, Ankara, 2019.
16. **Özbay, İlyas, İmamlık İrşad ve Cemaatle İletişim, Motto Yayınları, İstanbul, 2020.**

33 Sayar, Kemal, Zalaz, Berna, Ağ, İstanbul, 2019, f. 430.

34 Canan, Sinan-Acungil, Mustafa, Dijital Gelecekte İnsan Kalabilmek, İstanbul, 2019, f. 104.

17. Rigbey, Dr. Elizabeth, ocuęunuz Dijital Dnyanın Esiri Olmasın, Paloma Yayınları, İstanbul, 2019.
18. Samur, Yavuz, Yeni Bir Bildiriminiz Var, Nemesis Kitap, İstanbul, 2020.
19. Sayar, Kemal, Zalaz, Berna, Ağ, Kapı Yayınları, İstanbul, 2019.
20. Sayar, Kemal, Ruh Hali, Timaş Yayınları, İstanbul, 2015.
21. Uyan, Salih, Dijital Dnyada E-Beveyn Olmak, Timaş Yayınları, İstanbul, 2019.